NË KOSOVË NUK KA KORONAVIRUS!

Komunikatë për media

29/02/2020
Ora 20:45

Nga data 08.02 deri më
29.02.2020, në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKSHPK me metodën
RT-PCR, janë testuar gjithsej 33 mostra të dyshimta në virusin SARS-CoV-2 dhe
të gjitha kanë rezultuar negative.

Instituti Kombëtar i
Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK) gjatë ditës së sotme me 29 shkurt
2020, ka marrë informatë nga Klinika Infektive e QKUK për 3 raste të dyshimta
në COVID-19.

Pacientët u kontrolluan nga
ekipi i infektologëve në Klinikën Infektive në QKUK dhe iu morrën mostrat për
testim laboratorik në virusin SARS-CoV-2.

Me datë 29.02.2020, në
Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKSHPK janë

testuar 3 mostra të
pacientëve në virusin SARS CoV-2 dhe kanë rezultuar negative.

Nga data 01.02.2020 deri me
29.02.2020 nga aeroporti ndërkombëtar “Adem Jashari” si dhe pikat tokësore
kufitare janë depistuar gjithsej 924 udhëtarë. Nga Aeroporti “Adem Jashari” 172
udhëtarë, Vërmicë 351, Merdare 346, Hani i Elezit 22, Dheu i bardhë 26 dhe

Kullë 7 udhëtarë.

Aktivitetet në lidhje me monitorimin, parandalimin e rrezikut të përhapjes së COVID-19

1. Komiteti për monitorimin e sëmundjeve ngjitëse ka konstatuar se janë
   përforcuar masat për monitorimin, parandalimin e rrezikut të përhapjes së COVID-19 që konsistojnë në:

   - Vazhdimin e zbatimit të parimeve themelore nacionale
     të reagimit në sistemin e mbikëqyrjes
     së rasteve.

- Depistimin dhe detektimin e rasteve të dyshimta, si
  dhe përcjelljen e dinamikës së sëmundjes;
- Konfirmimin laboratorik të rasteve të
  raportuara;
- Aktivizimin e ekipeve për hulumtim të
  epidemisë;

- Ekipet e IKSHPK dhe Qendrat e Mjekësisë
  Familjare po përcjellin me vëmendje situatën epidemiologjike me Koronavirus në
  pikat hyrëse tokësore dhe aeroportin ndërkombëtar "Adem Jashari".

- Aktivitetet e rekomanduara nga Komiteti për
  monitorimin e sëmundjeve ngjitëse kanë vazhduar me masat për parandalimin e
  virusit në institucionet arsimore të Kosovës që konsistojnë në:

  - Shpërndarjen e materialeve të edukimit dhe promovimit
    shëndetësor, posterëve dhe lifleteve.
  - Organizimin e ligjëratave përkushtuar njohurive për
    koronaviruson COVID- 19, të organizuara nga arsimtarët dhe profesorët me
    përkrahje të specialistëve të
    shëndetësisë publike të IKSHPK.
  - Ndërmarrjen e hapave sipas rekomandimi të IKSHPK që në të
    gjitha institucionet
    shkollore të bëhet dezinfektimi i shtuar i të gjitha sipërfaqeve dhe nyjeve sanitare.

- Është ngritur shkëmbimi i informatave ndërinstitucionale mes Ministrisë
  së Shëndetësisë, IKSHPK, Qendrës së Situatave, Agjencionit për Menaxhimin e
  Emergjencave, SHSKUK, AUV, QKMF-ve, Policisë së Kosovës, FSK, MASHT.

- IKSHPK, thekson se nuk ka vend për panik, por për kujdes të shtuar duke përsëritur
  rekomandimet:

- Shmangni kontaktet e ngushta me njerëzit që vuajnë nga infeksione akute të frymëmarrjes!

- Sa të jetë e mundur shmangni përshëndetjen me shtrëngim të duarve!
    - Shmangni përqafimet dhe puthjet për aq kohë sa jeni në
      rrezik nga infeksionet respiratore!

- Lani shpesh duart, veçanërisht pas kontaktit të drejtpërdrejtë me njerëzit e sëmurë
  ose në vendqëndrimin e tyre!

- Lani duart porsa hyni në shtëpi!
    - Lani duart para fillimit të përgatitjes së ushqimit!
    - Lani duart pas përdorimit të tualetit!
    - Lani duart sa më shpesh me ujë e sapun 20-30 sekonda,
      veçanërisht pas kontaktit të
      drejtpërdrejtë me njerëzit e sëmurë ose në

vendqëndrimin e tyre!

- Evitoni përdorimin e tualeteve publike!

- Lani duart sa herë që teshtini apo kolliteni!
  - Shmangni prekjen e fytyrës dhe mbuloni gojën dhe hundën me faculetë, me mëngë ose parakrahë gjatë kollës dhe teshtitjes. Pastaj hudhni faculetat e përdorura në shportën më të afërt të mbeturinave!

- Nëse keni ethe, kollë dhe vështirësi në frymëmarrje kërkoni menjëherë ndihmë mjekësore dhe tregoni historinë eventuale të udhëtimit jashtë vendit!

- Personat e sëmurë duhet të qëndrojnë në shtëpi në mënyrë që të parandalohet përhapja e sëmundjes!

- Mos frekuentoni ambientet mbyllura dhe të mbingarkuara me njerëz!
  - Pini sa më shumë ujë, lëngje, çaj me limon!
  - Të moshuarit dhe personat me sëmundje kronike nëse përdorin transportin publik të përdorin maska!

- Gjatë udhëtimit përdorni ushqime të paketuara!
- Personat të cilët kanë qenë në provincën Wuhan, Kinë, zonat Lombardi, Veneto të Italisë apo zona të prekura nga COVID-19 brenda 2 javëve të fundit dhe kanë ethe, kollë ose vështirësi në

frymëmarrje, duhet menjëherë të kërkojnë ndihmë mjekësore!

- Nëse personi nuk ka qenë në kontakt
  të afërt me të sëmurin
  por vetëm është
  kontakt potencial për atë se ka qëndruar në vendet ku ka raste me
  COVID-19, personit të tillë i rekomandohet vetë-izolimi shtëpiak edhe në prani
  të anëtarëve tjerë të familjes.

- Kontaktet këshillohen për monitorim të shëndetit për
  14 ditë pas datës së fundit të ekspozimit dhe të kërkojnë kujdes të menjëhershëm
  shëndetësor nëse shfaqin ndonjë simptomë, veçanërisht ethe, temperaturë,
  simptoma të frymëmarrjes, siç janë kollitja ose vështirësi në frymëmarrje ose
  kanë diare.

- Kontaktet duhet të
  konsiderojnë ushtrimin e vetë-izolimit për 14 ditë në shtëpi

- Është me rëndësi që ky person nuk duhet të shkojë në
  punë, shkollë, kino dhe ambientet publike ku ka grumbullim të shumë personave

Rregulla e parë e izolimit në shtëpi është:

- Personat e moshuar dhe fëmijët të ndahen nga anëtarët tjerë të familjes.
- Të shfrytëzohen peceta, të dezinfektohen sipërfaqet dhe gjësendet, sa më shpesh të lahen rrobat, esenciale është mbajtja e higjienës së duarve dhe të shmanget prekja e hundës, gojës dhe syve.
- Gjatë kollitjes dhe teshtitjes të përdoret peceta dhe ato të hudhen në vende të sigurta.
- Nëse ka mundësi secili të bëjë gjumin në shtratin e vet dhe të shfrytëzojë banjo personale.
- Mos pranoni vizita nga të afërmit dhe miqtë në shtëpi.
- Nëse keni kafshë shtëpiake largoni ato ose pas çdo kontakti me to lani duart me ujë dhe sapun.
- Monitoroni simptomet e juaja.
- Thirrni mjekun tuaj para vizitës në kujdesin shëndetësor.
- Menaxhoni në mënyrën e duhur mbeturinat.
- Brenda mjediseve të institucioneve të kujdesit shëndetësor, të forcohen praktikat standarde të parandalimit të infeksionit dhe kontrollit në spitale, veçanërisht në shërbimet e urgjencës!
- IKSHPK rekomandon të gjithë që të mos udhëtojnë drejt Kinës ose zonave/ shteteve me Koronavirus, nëse nuk e kanë të domosdoshme!

Në nivel global, nga data 31 dhjetor 2019 deri më 29 shkurt 2020, janë raportuar gjithsej 85 203 raste me COVID-19 dhe gjithsej 2 921 raste të vdekjes, derisa në BE dhe Mbretëri të bashkuar, janë raportuar 1 161 raste me COVID-19 dhe 23 raste të vdekjes.

Në rast të ndryshimit apo përkeqësimit të situatës epidemiologjike me COVID – 19 në Kosovë, rekomandimet mund të pësojnë ndryshime.

Qytetarët do të jenë të informuar në kohë reale për çdo ndryshim eventual të tillë.